



MISIONI SHQIPTAR


Shën Nënë Tereza

Saint Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Mëshira Hyjnore

23 Prill 2017



*For the sake of
His sorrowful Passion,
have mercy on us and
on the whole world.*

—Chaplet of Divine Mercy

CNS photo/Nancy Wiehcek

Në mbremje po të asaj dite – të parën ditë të javës – ndërsa dyert e shtëpisë, ku banonin nxënësit, ishin të mbyllura prej frikës së judenjve, erdhi Jezusi, zuri vend midis tyre dhe u tha: “Paqja me ju!” Si u tha kështu, u tregoi duart dhe kraharorin. Nxënësit u gëzuan, kur e panë Zotërinë. Mandej u tha prapë: “Paqja me ju! Sikurse më dërgoi mua Ati, ashtu unë po ju dërgoj ju.” Si foli kështu, hukati mbi ta dhe u tha: “Merrni Shpirtin Shenjt! Atyre që jua falni mëkatet, u falen, e atyre që nuk jua falni, nuk u falen.” Porsi Toma, njëri prej të dymbëdhjetëve, ai që quhet Binjak, nuk ndodhi me ta kur erdhi Jezusi. I thanë, pra, nxënësit tjerë: “E pamë Zotërinë!” Toma u përgjigji: “Pa e parë në duar të tija vragën e gozhdave e pa e vënë gishtin tim në vend të gozhdave; pa e shtirë dorën time në kraharorin e tij, kurrë nuk besoj.” Mbas tetë ditësh nxënësit e tij ishin prapë brenda në shtëpi e me ta ishte edhe Toma. Megjithëse dyert ishin të mbyllura, erdhi Jezusi, zuri vend midis tyre dhe u tha: “Paqja me ju!” Mandej i tha Tomës: “Shtjere gishtin tënd këtu e qe, shihi duart e mia! Ma jep dorën tënde e shtjere në kraharorin tim dhe mos ji njeri që s’beson, por besimtar!” Toma i përgjigji: “Zotëria im dhe Hyji im!” Jezusi i tha: “Pse po më sheh, po beson. Lum ata që nuk panë e besojnë!” Jezusi bëri ndër sy të nxënësve të vet edhe shumë mrekulli tjera, të cilat nuk u shënuan në këtë libër. Këto u shkruan që të besoni se Jezusi është Mesia, Biri i Hyjit, dhe, që duke besuar, ta keni jetën në Emër të tij. *Gjn 20, 19-31*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 PM te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

25 Prill	Shen Marku ungjiljetar
26 Prill	Nëna e Keshillit te mire
27 Prill	Shen Anjeza
28 Prill	Shen Pjetri Shanel
29 Prill	Shen Katerina e Sienes
30 Prill	Shen Piu V, pape

Te marteve te Shna Ndout Mesha kremtohet ne oren 7:30pm

Haku Kishes 2017... E ka dhene:

Aleks	Coku
Altin	Miri
Arben	Toma
Gjergj	Nikolla
Illir	Shyti
Illir	Frrokaj
Kol	Pepa
Ljuc	Junçaj
Luigj	Gojani
Martin	Vuktilaj
Mhill	Ftoni
Nikolin	Vukelaj
Nikolle	Lumaj
Nush	Dokaj
Paulin	Marku
Pjerin	Brucaj
Pjeter &	
Bep	Dreshaj
Prek	Gjonaj
Prek	Spaqi
Prek	Spaqi
Tefe	Ndoci
Ton	Vocaj
Valmir	Gjinaj
Vaso	Gjuravçaj
Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!	

Per Fondin e ndertimit te Kishes ka dhene ...

Sokol Sterbyci	10000
Pjeter&Bep Dreshaj	10000
Ton Vocaj	10000
Aleks Coku	5000
Elis Bzhetaj	5000
Lec Gashaj	5000
Luigj Narkaj	5000
Luk Gjollaj	5000
Paulin Marku	5000
Anton Malaj	4000
Arben Pepa	3000
Luvigj Lallinaj	3000
Mirash Lallinaj	3000
Nik Biqi	3000
Anton Brunga	2500
Albert Berisha	2000
Aleks Dragu	2000
Altin Miri	2000
Artan Vuksani me vellezer	2000
Dritan Lumaj	2000
Edmond Ramaj	2000
Martin Vuktilaj	2000
Ndok Gjokaj	2000
Pjerin Kalaj	2000
Prek Gjonaj	2000
Shpend Plumbaj	2000
Sokol/Petrit Ujka	2000
Tom Prekulaj	2000
Lek Selmani	1500
Ndue Selmani	1500
Anton Shelinaj	1000
Arben Therqaj	1000
Edi Linadi	1000
Erald Islami	1000
Gezim Lanazi	1000
Gjelosh Vushaj	1000
Gjergj Gjinaj	1000
Gjovalin Melaj	1000
Lek Ramaj	1000
Mark Ndoci	1000
Mhill Ftoni	1000
Ndue Kabashi	1000
Petrit Ujkaj	1000
Prek Spaqi	1000
Prel Pushaj	1000

Qamil Llashtica	1000
Shqiprim Lumi	1000
Sokol Noshi	1000
Arben Toma	500
Dorian Tabaku	500
Fatmir Qosaj	500
Kol Pepa	500
Lec Ndoj	500
Pal Rrasburgaj	500
Sokol Kaçaj	500
Pren Prekaj	300
Ernesto Ujka (US dollar)	300
Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!	

Lutja e Gjon Palit II - Zojës së Shkodrës



O Zoja e Shkodrës, Pajtorja e Shqipërisë,
ti Nëna jonë e ëmbël!
Ti, që në zemër të rrjedh gjaku i popullit
tënd:
silli sytë e tu mbi këtë komb
që pati fatin ta marrë mësimin e parë të
Ungjillit
nga goja e Apostujve
e që Ty të nderoi përherë me dashuri të
pastër bijnore.
Edhe sot, në errësirën e provës,
ky komb të drejtohet Ty plot shpresë
e pret ndihmën tënde amtare.
Ti i prin Kishës në shtegtimin e fesë:
silli sytë e tu mbi bijtë e bijat shqiptare
në shtegtim, ngarkuar me prova e
mundime.
Forco të ligshetit, ngushëllo të mjeruarit,

mbaje të gjallë fenë në zemrat e të
gjithëve!
O Nënë e Shëlbuesit,
bekoji familjet e krishtera, thelb i Kishës
së Birit tënd hyjnor!
Nënë e shpresës, shpejtoje ditën kur ky
popull fisnik
do t'i shikojë të realizuara edhe njëherë
të gjitha dëshirat e thella të shpirtit të tij,
atëherë kur të gjithë, bij e bija,
do të kenë mundësinë të bashkohen në
harmonitë plotë
për të rindërtuar të ardhmen në drejtësi e
paqe. Amen.

550-vjetori i arritjes së Zojës së Shkodrës në Gjenacan: "Portat e ferrit nuk ngadhënjyen!"



Gjatë pushtimit otoman Kisha e Zojës
dalëngadalë u kthye në gërmadhë. E
ashtu mbeti deri pas pavarësisë së
Shqipërisë, kur u rikrijuan kushtet për
rindërtimin e saj.

Punimet rifilluan pikërisht më 1917, në
kulmin e Luftës I Botërore. E, më 23-26
prill 1917 u kremtua me madhështi 450-
vjetori i shpërnguljes së Zojës nga
Shkodra – në Gjenacan. Ishte një festë
jashtëzakonisht prekëse për atë grusht
katolikësh, që i bënë ballë pesëqind vjet
robërie e mohimi, e që, më në fund dolën
nga katakombet e pushtimit ende gjallë,

me besim të plotë në ndërmjetësimin e Nënës së Këshillit të Mirë. Festa ishte e paharrueshme. Merrte pjesë në kremtim Argjipeshkvi i Shkodrës, imzot Jak Serreqi; argjipeshkvi i Durrësit, imzot Prend Bjanku; ipeshkvijtë e Lezhës e të Zadrimës, imzot Luigj Bumçi dhe imzot Gjergj Koleci. Të pranishëm, përveç autoriteve vendore, Kryekomandanti i Korparmatës XIX austrohungareze, Gjenerali Ignatius Trollmann; Konsulli i përgjithshëm, August Ritter von Kral, i cili gjatë Luftës I Botërore zinte vendin e Komisarit civil në Shqipëri dhe konsulli Karl Halla.

Atmosfera e festës u bë edhe më gazmore nga tingujt e Bandës ushtarake austriake, asaj qytetse dhe nga pjesëmarrja e Scola Cantorum e katedrales së Shkodrës.

Për rindërtimin e kishës ndihmoi njëzemre e njëzëri populli i Shkodrës, dhe i fshatrave të arkidioqezës. Gratë hoqën rrathët e martesës nga gishti, vëthët nga veshët e kolanat e arta nga fyti, e ia falën asaj Zoje, që ua kishte pritë sa e sa herë rrezikun atyre vetë, burrave e fëmijëve të tyre, në ato kohë të trazuara lufte. Përveç ipeshkvijve, klerit e autoriteteve qytetse dhe krejt popullit, u bashkuan në mënyrë kuptimplote teologët shqiptarë pranë Universitetit të Innsbruck-ut, në Austri, të cilët me anën e një fushate në shtypin austriak, mblodhën një shumë të rëndësishme të hollash.

Trualli ku ishin gërmadhat e shenjtërores së lashtë, një sipërfaqe prej 10.262 m² e me vlerë 7.500 korona austriake, iu dhurua, nga Komanda e Naltë e Korparmatës XIX austriake,

argjipeshkvisë së Shkodrës. Për ta ligjëruar këtë akt, u hartua një dokument pronësie që, më 7 korrik 1917, iu dorëzua kryepeshkvit të Shkodrës, imzot Jak Serreqi. Ky ishte hapi i parë... Më 31 korrik u bekua edhe guri i parë, që u vendos në themele më 17 gusht, nga gjenerali Trollmann. Ai vetë zbriti në gropën e themeleve e, bashkë me gurin, vendosi aty edhe një pergamenë. Askujt nuk do t'i kish shkuar në mendje asokohe se Kisha do të hidhej në erë me dinamit e se një Kishë e tretë, e re, do të naltohej ndër gërmadhat dy herë të vjetra, mbi një gur themeli, që do ta vendoste, e edhe do ta bekonte, jo më një gjeneral ushtrie, por "Gjenerali i të gjithë katolikëve të botës", Papa i Romës, Gjon Pali II. Pllaka e bardhë prej mermeri e vendosur në hyrje, vijon të jetë dëshmitare e heshtur e kësaj mrekullie, që ndodhi me 25 prill 1993...

Egypt awaits the 'Pope of Peace'



Preparations are in full swing for Pope Francis' upcoming apostolic visit to Egypt. The Pope is scheduled to fly to Cairo on Friday 28th for a 2-day pastoral journey.